



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 16.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës; 16.03.2022, të parashtruar nga **EURO TESTING SH.P.K, nga Prishtina**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure” me Nr. të Prok: 613 022 002 236.

### V E N D I M

**I Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e **EURO TESTING SH.P.K, nga Prishtina** të dt. 16.03.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure”, me nr. të Prok: 613 022 002 236.

**Vërtetohet** Vendimi i AK për Anulim të procedurës, i datës 14.03.2022, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për anulim të procedurës i publikuar me datë: 14.03.2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**EURO TESTING SH.P.K, nga Prishtina**, me datë 16.03.2022, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW, në SHFMU Haradin Bajrami Magure” me nr. të Prok: 613 022 002 236, ku në këtë aktivitet AK ka anuluar procedurën me datë: 14.03.2022, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

**EURO TESTING SH.P.K, nga Prishtina, me datë. 16.03.2022, ka parashtuar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure” Autoriteti Kontraktues, me datë 16.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:**

*Autoriteti Kontraktues, gjatë vleresimit të ofertes tuaj ka konstatuar që juve ju mungon:*

- 1. Një listë të kontratave të realizuara ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin.**
- 2. Referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve.**

Bazuar në Legjislacionin e Prokurimit Publik, përkatësisht në Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik nr A01, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.02.2021, i cili në nenin 39 pika 8 (shembulli nr.3) përcakton:

**“Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)- Mund të kërkojnë informata sqaruese.”**

**Ndërsa, ju në ofertën tuaj nuk keni dorëzuar listën e kontratave dhe as dëshmitë e kërkuara atëherë ju kemi eliminuar nga ky tender. Në rast se do t’i kishit dorëzuar njërën nga këto dokumente, ne do të kishim kërkuar sqarime shtesë nga ana juaj.**

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat dhe udhëzimet e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

**Bekim Shabani**  
  
**Drejtori Prokurimit**

